

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SUHAREKË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **624-23-287-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Projekt me bashkfinancim -Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytë-ritender**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.P.N. HIDROTERM SH.P.K
NUI	600018312
Adresa	Brigada 123
Vendi	Suhareke
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	045 669 966
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Blertë Kuçi
Adresa elektronike	info@hidroterm.info
Data e parashtrimit të ankesës	15.06.2023

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike



3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Projekt me bashkfinancim -Ndërtimi i shtepisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytë-ritender

PProjekt me bashkfinancim -Ndërtimi i shtepisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytëritender

Përmesë platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Suharekës për Projekt me bashkfinancim -Ndërtimi i shtepisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytë-ritender, me numer prokurimi: 624-23-278-5-1-1 & 624-23-02-5-1-1 ku keni rekomnduar për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik CONSTRUMAX SH.P.K, HARST Group SH.P.K., EBK SH.P.K., Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh, 23000, Suharekë. Me datë 02.06.2023 kemi paraqitur kërkesën për ri-shqyrtim, dhe me datë 9.06.2023 kemi pranuar Vendimin mni Refuzimin nga AK- Suharekë

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Përmesë platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Suharekës për Projekt me



bashkfinancim -Ndërtimi i shtepisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytë-ritender, me numer prokurimi: 624-23-278-5-1-1 & 624-23-02-5-1-1 ku keni rekomnadar për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik CONSTRUMAX SH.P.K, HARST Group SH.P.K., EBK SH.P.K., Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh, 23000, Suharekë. Me datë 02.06.2023 kemi paraqitur kërkesën për ri-shqyrtim, dhe me datë 9.06.2023 kemi pranuar Vendimin mni Refuzimin nga AK- Suharekë

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7

Neni 1

Nenit 30, pika 30.4 e A01- Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar me datë 31.05.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Suharekës për **Projekt me bashkfinancim -Ndërtimi i shtepisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytë-ritender**, me numer prokurimi: **624-23-278-5-1-1 & 624-23-02-5-1-1** ku keni rekomnadar për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik **CONSTRUMAX SH.P.K, HARST Group SH.P.K., EBK SH.P.K.**, Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh, 23000, Suharekë Ndërsa neve na keni shpallur si tenderi i pa përgjegjshëm me arsyetimin: Tenderi juaj është refuzuar AK ka dërguar letër standarte për vazhdimin e validitetit të ofertës me datën 23.05.2023 dhe nuk keni dërguar deklaratë për vazhdimin e validitetit të ofertës.

Ne ju njoftojm se Kompania jonë- Hidroterm Sh.P.K as përmes platformës e as pëmesë e-mailit nuk ka pranuar kurrfar njoftim-kërkese për vazhdim të validitetit nga ana e AK-Suharekë. Poashtu ju rikojtoj se: Në bazë Rregullorës së Prokurimit Publik, **Neni 30 - Validiteti i Tenderit, pika 30.4** - Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve



komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohej para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem **(është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)**. Andaj këtu shihet se Autoriteti Kontraktues bie ndesh-shkelje Ligjore duke mos respektuar fare piken 30.4 Ku AK -Suharekë nuk ka provuar asnjherë të verifikoj që të gjithë tenderet të pranojnë kërkesën për zgjatje të validitetit ku ne NUK JEMI Njoftuar për këtë Kërkesë, e saktësisht po e ri citoj **(është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)**. Ne ju njoftojm se Kompania Hidroterm Sh.P.K vazhdon të qëndroj në ofertën e dhenën në këtë aktivitet dhe deklaron se vlefshmeria e tenderit është edhe për 90 ditë tjera.

Poashtu AK-Suharekë ka vepruar në kundërshtim ligjor me këtë dispozitë ligjore ku specifikisht thuhet citim: *“Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohej para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem”* dhe një gjë e tillë duhet të verifikohet, me qka sipas Njoftimit të vendimit të AK në B42 Letër standarte për tenderuesin e eliminuar³ kanë arsytuar se me datë 23.05.2023 është kërkuar me leter standarte për vazhdim të validitetit të ofertës. E nëse marrim Shkak se deri në cilën datë kanë qenë valide ofertat, kjo nënkupton që ofertat kanë qenë pa validitet disa ditë për të gjithë OE pjesëmarrës në këtë procedurë. Me qka arsytimi i AK-Suharekë është në kundërshtim ligjor me këtë Nen duke mos përfillur afatet kohore të përcaktuar në mënyrë ligjore sipas LPP-se dhe **A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik**.

Me datë 01.06.2023 kemi parashtruar kërkesë përmesë e-mailit për çasje në dokumentet publike të këtij aktiviteti, dhe me datë 01.06.2023 kemi marrë ofertat e të gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet si dhe vërtetimet e çertifikatat për Grupin e operatorëve të propozuar për Kontratë.

Me datë 02.06.2023 kemi paraqitur Kërkesën për Ri-Shqyrtim përmesë platformës e-prokurimi dhe me datë 09.06.2023 AK -Suharekë bie vendimin mbi refuzimin e kërkesës tone, me të cilë konsiderojm se është i padrejtë dhe jo i bazuar sipas LPP-së dhe Rregulloreve dhe Udhezuesit për Prokurim publik, ku në pretendimet tona nuk bashkangjitet argumenton asnjë fakt por vetëm refuzon kërkesën për Ri-Shqyrtim, edhe pse në kërkesën për ri-shqyrtim kemi të listuar pretendimet tona që Konkursiumin i shpallur fitues nuk i plotëson kriteret e FDT dhe Njoftimit për kontratë të vendosur nga AK-Suharekë.

Të njëjtat po ua parashtrojm si në vijim:

Grupi i Operatorëve Ekonomik CONSTRUMAX SH.P.K, HARST Group SH.P.K., EBK SH.P.K., janë të Papërgjegjshëm sepse nuk plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë së tenderit të kërkuara sipas FTD dhe njoftimit për Kontratë dhe atë”



Argumenti 1: Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1 - Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rks-gov.net>

Dëshmia 1 - Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-42, Plotësimi i Aneksit Nr. 2 të Dosjes së Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. **3. Një vërtetim nga Gjykata që vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor.** Për pikën (a) dhe (b) Kërkohej origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontrate të sjelle dokumentet të kërkuara në pikën, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, të konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është listuar në vendin e dytë.

Pretendimi 1- Grupi i Operatorëve Ekonomik CONSTRUMAX SH.P.K, HARST Group SH.P.K., EBK SH.P.K., e Përkatësisht **Drejtori i OE Harst Group Sh.P.K, SADIK RAMADANI**, sipas çertifikatës Nr. 6FA6D8982BC74EE, mbi denimet Penale, të lëshuar me datë 04.05.2023 nga Këshilli Gjyqësor I Kosovës, Vërteton se Është i Dënuar për Vepër Penale me Aktgjykim të Formës së Prerë, Nr P=428/2020 të datës 25.06.2023.

Andaj AK =Suharekë në mënyrë të drejtëpërdrejtë bie ndesh me kërkesën 1 të përshtatshmërisë ku në dëshmi kërkohej që Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale, e këtu kemi Drejtuesin e OE Harst Group **Sadik Ramadani të Dënuar për Vepër Penale. ME qka AK është dashur që të eliminoj menjeherë sit ë Papërgjeshëm i cili bie ndesh me Pikën 3 të dëshmisë së kërkuar për pajtueshmërinë ligjore.**

Argumenti 2. - Neni 3 : Informacionet ligjore ekonomike, financiare dhe teknike

Neni 3.1.2- Forma ligjore që merret sipas grupit të operatoreve ekonomik (sipas FTD)



III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet): Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë, nga një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i jepet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. një deklaratë të B05 Njoftim per Kontrat 4 / 9 nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. **një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit**, dhe të gjithë operatorët ekonomik duhet t'i dorëzojnë dëshmitë e kërkuara në pajtim me dispozitat e paragrafit III pika 2.1 dhe 2.2 Secili anëtar i Grupit te Operatoreve Ekonomik duhet te regjistrohet në platformën elektronike.

Pretendimi 2.- Grupi i Operatorëve Ekonomik CONSTRUMAX SH.P.K, HARST Group SH.P.K., EBK SH.P.K. në oferten e tyre të dorëzuar ju **Mungon DEKLARATA, pika C. Citim:** “ *Nje deklarate te nenshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesorë për të vepruar në emër të grupit*”. **Me qka Siaps UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe kërkesës së pikes c, Grupi i Operatorëve Ekonomik nuk kanë autorizuar njërin nga OE në koncerzium për të vepruar në emër të grupit.**

Argumet 3.- III.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Kërkesa 2 - Operatori Ekonomik duhet të ketë mjete financiare të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku 1,000,000.00 € ose dëshmi mbi akses në kredi nga një Bankë, për të njëjtën vlerë (1,000,000.00 €) në emër të të njëjtit Aktivitet të Prokurimit.

Dëshmia 2 - Dokument i lëshuar nga institucioni bankar i cili dëshmon se Operatori Ekonomik posedon mjetet e gatshme financiare në bankë ose Dokument i lëshuar nga institucioni bankar i cili dëshmon se Operatori Ekonomik do të ketë akses në kredi për të njëjtën vlerë (1,000,000.00 €) në emër të të njëjtit Aktivitet të Prokurimit. Dokumenti duhet të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt.

Pretendim 3. Grupi I OE ka ofruar një konfirmim nga PCB me të cilën konfirmon se PCB do të konsideroj mbështetjen financiare duke u bazuar në kapacitetin e tij financiar pas analizës financiare të bërë nga analistët tanë të kredive për shumën e kërkuar prej 1,000,000 euro.

Kjo nuk nënkupton që mund të ketë akses në këtë vlerë të kërkuar, me çka nuk i jep siguri



AK.

(Për këtë vlerë nuk është përfunduar as analiza financiare për aprovim të aksesit në kredi sipas dokumentit të lëshuar nga banka). Andaj Grupi i OE të shpallur fitues nuk plotësojn këtë kërkesë të AK të kërkuar në FTD.

Argument 4.- Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 1 - Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme kombëtare apo ndërkombëtare, (**ndërtim i lartë**), në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlerë minimale prej 4,650.000.00 €. Në rast të ofertimit në konzercium lideri duhet të plotësoi së paku 40% të kërkesës.

Dëshmia 1 - Një listë te kontratave të realizuara, ku përfshihen titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve në vlerë prej 4,650.000.00€.

Pretendim 4. Mungojnë referencat në vlerën prej 4.650.000,00 euro, për punë të kërkuara sipas kërkesës.(Grupi i OE ka ofruar referenca dhe kontrata të renovimeve, demolimeve, drenazhimeve etj. te cilat nuk hyn te veprimtaria e ndërtimeve të larta). *Andaj Grupi I OE të shpallur fitues nuk e plotëson këtë kërkesë të AK të kërkuar në FDT.*

Argument 5.- Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 3 - Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës

ne Aneksin 7 të DT duhet të jenë në gjendje të rregullt funksionale- deklarata e operatorit ekonomik që dëshmon se mjetet të cilat planifikon ti përdorë jenë në gjendje të mirë operacionale.

Dëshmia 3 -Deklaratë e operatorit ekonomik që dëshmon se mjetet të cilat planifikon ti përdorë jenë në gjendje të mirë operacionale. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj



edhe marrëveshjen për shfrytëzim.

Pretendim 5- (MUNGON DEKLARATA sipas dëshmisë 3). *Grupi i OE të shpallur fitues në ofertën e tyre nuk kanë bashkëngjitur këtë deklartë të cilën është kërkuar nga AK-Suharekë ku me këtë rast AK është dashur që të refuzojnë ofertën e tyre, pasi nuk plotësoj kriterin e pikës 3 të dëshmisë të kërkuar në FDT.*

Argument 6- Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 4 - Operatori Ekonomik duhet të dorëzon me Ofertën e tij, “Planin Dinamik të Detajuar” për secilin pozicion të përshkruar në Paramasë. Për secilin pozicion të përshkruar në paramasë duhet të shënohet data e fillimit dhe data e përfundimit të pozicionit dhe kohëzgjatja, numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Gjithashtu, së paku në rreshtin e fundit, të shënohen të dhëna për numrin e përgjithshëm të punëtorëve dhe stafit të OE të angazhuar në punishte në ditën apo datën e caktuar në “Planin Dinamik”. Në planin dinamik të shënohen ditët e pushimit (ditët e diela) si dhe ditët e festave sipas kalendarit të festave të Republikës së Kosovës.

Dëshmia 4 - Plani dinamik duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga OE.

Pretendim 6- Grupi i OE ofertues ka ofruar plan dinamik në kundërshtim me këtë kërkesë duke vendosur edhe ditën e SHTUNË si ditë pushimi.

Poashtu në bazë të aneksit 6 Kriteret për dhenjen e kontratës pika 2 : “Plani dinamik detal me afat kohor më të shkurtër për AK jo më të gjatë se 400 ditë”.

OE është dashur në këtë kërkesë të paraqesin ofertën e tyre dhe AFATIN KOHOR që nënkupton kohën nga dita e parë e fillimit të punimeve e deri në ditën e fundit të punimeve (ku mbrenda saj është dashur të llogariten edhe ditët e pushimit).

Paraqitja vetëm e ditëve të punës ndikon direkt në rezultatin e vlersimit të poentimit në këtë kriter.

Andaj pas prezantimeve të fakteve më lartë, kërkojm nga OSHP që pas shqyrtimit të kësaj Ankese të nxjerrë këtë :

VENDIM

I. APROVOHET, si e bazuar Ankesa e Hidroterm SH.P.K



- II. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Ak-së i dates 31.05.2023 për dhënie të Kontratës dhe lënda kthehet në **Ri-Vlerësim** dhe gjatë ri-vlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të bëhët konform LPP-së dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik, dhe të kujdeset për zbatimin e Nenit 30, pika 30.4 të Rregullorës për Prokurim Publik Nr.001/2022, Ose
- III. Të Vendos në mënyrë Meritore duke Shpallur fitues Oferten e vetme të Përgjeshme Hidroterm Sh.P.K

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ky aktivitet deri me tani na ka sjellur shpenyime duke përfshirë pagaditjen e fdt- si dhe shpenyimet tjera si kërkesa për ri-shqyrtim e ankesa në vlerë prej 18.000.00 Euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

